



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.155

22 nëntor

2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i Kuvendit nr.143, datë 20.11.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për shkarkim ministri	4507
Vendim i Kuvendit nr.144, datë 20.11.2007	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërim ministri	4507
Vendim i KM nr.744, datë 30.10.2007	Për trajtimin financiar të anëtarëve të Komitetit Kombëtar të Transfuzionit	4507
Vendim i KM nr.748, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të burimit ujqor nr.4/1, në zonën Uji i Ftohtë, Vlorë dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4508
Vendim i KM nr.749, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të burimit ujqor nr.6/1, në zonën Uji i Ftohtë, Vlorë dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4508
Vendim i KM nr.753, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Dragobia” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4509
Vendim i KM nr.754, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Valbona” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4509

Vendim i KM nr.755, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentralit “Gizavesh” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4510
Vendim i KM nr.756, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Vukli 1” dhe “Vukli 2” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4510
Vendim i KM nr.757, datë 7.11.2007	Për përcaktimin e autoritetit kontraktues, për dhënien me koncesion të hidrocentraleve “Dukagjin 1”, “Dukagjin 2” dhe “Dukagjin 3” dhe miratimin e bonusit, në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë	4511
Vendim i KM nr.758, datë 7.11.2007	Për dhënien në përdorim, pa shpërblim, të një sipërfaqeje prej 100 m ² shoqatës jofitimprurëse “Aksion Plus”	4511
Vendim i KM nr.759, datë 14.11.2007	Për disa ndryshime në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministrave të linjës”	4514
Udhëzim i MF & METE nr.23, datë 12.11.2007	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr.1, datë 8.1.2007 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve të shoqërive tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”	4517
Udhëzim i METE nr.849, datë 16.11.2007	Për disa ndryshime në udhëzimin nr.548, datë 2.8.2007 “Për shoqëritë anonime “në likuidim e sipër”, me kapital tërësisht shtetëror”	4518
Kërkesë e MPPTT nr.8095/1, datë 2.11.2007	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen-Kalimash”	4518
Kërkesë e MPPTT nr.109/1, datë 15.11.2007	Për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të pusit të ujit nr.3 Vrion dhe lidhjes me tubacionin e ujësjellësit të Navaricës	4522
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Ferat Bushi.....	4522
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Armand Koxhaj.....	4522
	Kërkesë për shpalljen të vdekur të shtetasit Nazmi Avdurramani...	4522

VENDIM
Nr.143, datë 20.11.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR SHKARKIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5518, datë 19.11.2007 të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5518, datë 19.11.2007 për shkarkimin e zotit Ilir Rusmali nga detyra e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.144, datë 20.11.2007

PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS
PËR EMËRIM MINISTRI

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr.5519, datë 19.11.2007 të Presidentit të Republikës

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr.5519, datë 19.11.2007 për emërimin e zotit Enkelejd Alibeaj në detyrën e Ministrit të Drejtësisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE
Jozefina Topalli (Çoba)

VENDIM
Nr.744, datë 30.10.2007

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ANËTARËVE TË KOMITETIT KOMBËTAR TË
TRANSFUZIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2 të nenit 16 të ligjit nr.9739, datë 21.5.2007 “Për shërbimin e transfuzionit të gjakut në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komiteti Kombëtar i Transfuzionit mbledhet rregullisht, 2 herë në vit, me urdhër të Ministrit të Shëndetësisë.

2. Pagesa e anëtarëve të këtij Komiteti, për përgatitjen dhe zhvillimin e çdo mbledhjeje, të jetë në shumën 5000 (pesë mijë) lekë.

3. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar, për këtë qëllim, për Qendrën Kombëtare të Transfuzionit të Gjakut.

4. Ngarkohet Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.748, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË BURIMIT UJOR NR.4/1, NË ZONËN UJI I FTOHTË, VLORË DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënie me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të burimit ujor nr.4/1, në zonën Uji i Ftohtë, Vlorë, është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

2. Miratimin e bonusit prej 7 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Natyral Resources” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.749, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË BURIMIT UJOR NR.6/1, NË ZONËN UJI I FTOHTË, VLORË DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të burimit ujor nr.6/1, në zonën Uji i Ftohtë, Vlorë, është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave.

2. Miratimin e bonusit prej 6 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Polar” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.753, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “DRAGOBIA” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Dragobia”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 8.5 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “TPLANI” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.754, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “VALBONA” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Valbona”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 8.5 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “TPLANI” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.755, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT “GIZAVESH” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentralit “Gizavesh”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 8 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Dardania Energi” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

VENDIM

Nr.756, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “VUKLI 1” DHE “VUKLI 2” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Vukli 1” dhe “Vukli 2”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 8.5 për qindsh të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Interenergo Albania” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.757, datë 7.11.2007

PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALEVE “DUKAGJIN 1”, “DUKAGJIN 2” DHE “DUKAGJIN 3” DHE MIRATIMIN E BONUSIT, NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 3, e 23, pika 3 shkronja “b” të ligjit nr.9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore, për dhënien me koncesion të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) të hidrocentraleve “Dukagjin 1”, “Dukagjin 2” dhe “Dukagjin 3”, është Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

2. Miratimin e bonusit prej 9.5 për qind të pikëve, për rezultatin teknik dhe financiar, në procedurën konkurruese përzgjedhëse (propozim i pakërkuar), që i jepet shoqërisë “Interenergo Albania” sh.p.k.

3. Ngarkohet Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM

Nr.758, datë 7.11.2007

PËR DHËNIEN NË PËRDORIM, PA SHPËRBLIM, TË NJË SIPËRFAQEJE PREJ 100 M² SHOQATËS JOFITIMPRURËSE “AKSION PLUS”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 901 e vijues të Kodit Civil, dhe të nenit 4 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe të Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien në përdorim, pa shpërblim, të sipërfaqes prej 100 m² në administrim të Qendrës së Zhvillimit të Fëmijëve, Tiranë, shoqatës jofitimprurëse “Aksion Plus”, për ndërtimin e “Qendrës për rehabilitimin e përdoruesve të drogës dhe për veprimtaritë në luftën kundër HIV/AIDS”, sipas planimetrisë dhe planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ministria e Shëndetësisë autorizohet që të lidhë aktmarrëveshjen përkatëse me shoqatën jofitimprurëse “Aksion Plus”, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Ngarkohen Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe Ministria e Shëndetësisë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

ZYRA VENDORE E REGJISTRIMIT
TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
TIRANË.




REGJISTRUESI
MAJLINDA BOZGO

Vulë/Firmë

ZONA KADASTRALE 8160 NR I PASURISË 4/302 Vol 11 Fq 17
INDEKSI I HARTËS TR-1243-5-13 SHKALLA 1:500
ADRESA E PASURISË: Rrethi TIRANË
Q/F TIRANË Rr/V STANRI VIMJACI
P/G Sh K Ap C. PRONARI
B. KUFIZIMET SHET
V. _____
L. _____
J. _____
P. _____
DATA ___/___/___ ORA _____





TERITORI I AMBASADES AMERIKANE

TR-R-13

Tirana 20 Tetor 1993

Rilievi i Tiranës
Shk. Y: 500 Vith 1993

Shoqëria ndërkombëtare Gjeologji-Gjeodezi
Kërkimet Gjeologjike dhe Gjeodeze
Gjeodezi
Ahmeti Ing. Gjergj Nagji
Nr. Licensës



244

VENDIM
Nr.759, datë 14.11.2007

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.478, DATË 18.7.2007 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË
NËPUNËSVE TË DISA INSTITUCIONEVE, NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit, të vitit 2007”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.478, datë 18.7.2007 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në shkronjën “a” të pikës 1, emërtesa “Enti i Turizmit” zëvendësohet me “Agjencia Kombëtare e Turizmit”.

2. Lidhja nr.1/2 e përmendur në pikën 2/2, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Lidhja nr.2/1-B zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

4. Lidhja nr.3 e përmendur në pikën 4, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

5. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për:

- institucionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të fillojnë nga data e hyrjes në fuqi të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave, për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Turizmit;

- të gjitha parashikimet e tjera, të fillojnë nga data 1 korrik 2007.

6. Efektet financiare, për vitin 2007, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e parashikuara për rritjen e pagave, në ligjin nr.9645, datë 27.11.2006 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2007”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Përfundimisht për periudhën nga data e emërimit për nëpunësit në Drejtorinë e Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm të sistemit të burgjeve, në Ministrinë e Drejtësisë, deri në datën e hyrjes në fuqi të vendimit, vlera e pagës për këta nëpunës të jetë sipas vendimit nr.711, datë 27.12.2001 të Këshillit të Ministrave.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LIDHJA NR.1/2

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË BURGJEVE

POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT	SHTESA PËR KUSHTE PUNE
		1	2	3		
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)	
Titullari i institucionit	II-a	10,050	2%		100,500	10,000
Zëvendëstitullar i institucionit	II-b	10,050	2%		84,000	8,000
Drejtor i Drejtorisë së SHKBB		10,050	2%		84,000	15,000
Drejtor Drejtorie	III-a	10,050	2%		65,000	6,000
Përgjegjës sektori në drejtorinë e SHKBB		10,050	2%		65,000	10,000
Përgjegjës sektori	III-a/1	10,050	2%		55,000	6,000
Përgjegjës sektori Inspektor	III-b	10,050	2%		49,000	0
Specialist/inspektor në drejtorinë e SHKBB		10,050	2%		49,000	10,000
Specialist	IV-a	10,050	2%		37,450	5,000
	IV-a	10,050	2%		37,450	0

LIDHJA NR.2/1-B

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË PUNONJËSVE TË TRUPËS ARTISTIKE NË TEATRIN KOMBËTAR, TEATRIN KOMBËTAR TË OPERAS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR DHE NË DREJTORINË E TEATRIT TË FËMIJËVE, NË QENDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË

I-Për Teatrin Kombëtar dhe Drejtorinë Artistike të Teatrit të Operas dhe Baletit, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansambilit Popullor

Nr.	Pozicioni	Paga
1.	Dirigjent Regjisor Solist i parë Koncertmaester Baletmaestër Aktor i parë	65.050 lekë

2.	Asistent dirigjent Asistent regjisor Solist II (spala sektori) Aktor i dytë	59.050 lekë
3.	Orkestrant i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Balerin i kategorisë së parë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së parë	47.500 lekë
4.	Orkestrant i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Balerin i kategorisë së dytë Aktor i tretë Skenograf i kategorisë së dytë	35.900 lekë

II. Për Drejtorinë Artistike të Ansamblit të Këngëve dhe Valleve Popullore, në Teatrin Kombëtar të Operas, Baletit dhe Ansamblit Popullor dhe Drejtorinë e Teatrit të Fëmijëve në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë

Nr.	Pozicioni	Paga
1.	Dirigjent Regjisor	59.050 lekë
2.	Solist i parë Orkestrant i kategorisë së parë Aktor i parë Skenograf i kategorisë së parë Korist i kategorisë së parë Valltar i kategorisë së parë	47.500 lekë
3.	Solist i dytë Orkestrant i kategorisë së dytë Aktor i dytë Skenograf i kategorisë së dytë Korist i kategorisë së dytë Valltar i kategorisë së dytë	35.900 lekë

LIDHJA NR.3

STRUKTURA DHE NIVELET E PAGAVE TË NËPUNËSVE NË INSTITUCIONET QENDRORE TË GRUPIT TË TRETË

PAGA MUJORE					
POZICIONI	KATEGORIA	PAGA INDIVIDUALE (PAGA BAZË)			SHTESA E POZICIONIT
		1	2	3	
		Paga e grupit (PG)	Shtesa vjetore për vjetërsi (SHV)	Shtesa për kualifikim (SHK)	Shtesa e pozicionit (SHP)
Titullar i institucionit	III-a	10,050	2%		65.000

Kapiten i përgjithshëm i kapitenerisë së përgjithshme të Porteve.					
Drejtor drejtorie Zv/kapiten i kapitenerisë së përgjithshme të porteve	III-b	10,050	2%		49.000
Përgjegjës sektori Inspektor	IV-a	10,050	2%		37.450
Specialist Restaurator	IV-b	10,050	2%		25.850
Lektor Arkivist/Katalogist Historian	IV-c	10,050	2%		19.900

UDHËZIM
Nr.23, datë 12.11.2007

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.1, DATË 8.1.2007 “PËR PROCEDURAT E PRIVATIZIMIT ME ANKAND TË PAKETAVE SHTETËRORE TË AKSIONEVE TË SHOQËRIVE TREGTARE QË VEPROJNË NË SEKTORËT JOSTRATEGJIKË”

Në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.119, datë 18.3.2000 “Për procedurat e privatizimit me ankand të paketave shtetërore të aksioneve në shoqëritë tregtare që veprojnë në sektorët jostrategjikë”, i ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.119, datë 27.2.2003 dhe me vendim të Këshillit të Ministrave nr.776, datë 11.10.2006, Ministri i Financave dhe Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës,

UDHËZOJNË:

1. Paragrafi IV i pikës 2, germa A, kapitulli II, ndryshohet, si më poshtë vijon;

Vendosja e afisheve të publikimit pranë shoqërive që privatizohen, si dhe në mjediset publike të vendndodhjes së subjektit, të bëhet nga degët e shoqërive publike në prefekturë, sipas të dhënave të dërguara nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave. Degët e shoqërive publike në prefekturë, brenda afateve të publikimit, dërgojnë zyrtarisht procesverbalin e vendosjes së afisheve në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike.

2. Pika 2 e germës “B” kapitulli II ndryshon, si më poshtë vijon:

Brenda 30 ditëve nga data e publikimit të radhës, punonjësit e shoqërisë bëjnë regjistrimin e kërkesave për zotërim aksionesh në këmbim të bonove të privatizimit në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike, në bazë të përcaktimeve të pikave 1, 2, 3 të shkronjës B të këtij vendimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI E FINANCAVE
Ridvan Bode

MINISTRI I EKONOMISË, TREGTISË
dhe energjetikës
Genc Ruli

UDHËZIM
Nr.849, datë 16.11.2007

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.548, DATË 2.8.2007 “PËR SHOQËRITË ANONIME “NË LIKUIDIM E SIPËR”, ME KAPITAL TËRËSISHT SHTETËROR”

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës, ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, seksioni V “Likuidimi”, ligji nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, i ndryshuar, Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, me cilësinë e aksionarit të vetëm të shoqërisë,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.548, datë 2.8.2007 “Për shoqëritë anonime “në likuidim e sipër”, me kapital tërësisht shtetëror”, bëhen këto ndryshime:

1. Në pikën 4 fjala “blihen” zëvendësohet me fjalën “shpërndahen”.
2. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë:
9. Vlera fillestare e ankandit për shitjen e objekteve, truallit dhe makinerive e pajisjeve të jetë vlera e përcaktuar nga ekspertë vlerësues të emëruar nga Ministria e Ekonomisë Tregtisë dhe Energjetikës me kërkesën e likuidatorit të shoqërisë. Ekspertët vlerësues do t’i referohen çmimeve të tregut. Kësaj vlere i shtohet vlera sipas kontabilitetit e inventarit ekonomik dhe vlera e mjeteve të xhiros së objektit përkatës.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**MINISTRI I EKONOMISË,
TREGTISË DHE ENERGETIKËS
Genc Ruli**

KËRKESE
Nr.8095/1, datë 2.11.2007

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private (objekte), që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Rrëshen-Kalimash”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

Për të gjithë pronarët që në kolonën shënime në tabelën e publikuar, është bërë shënimi “Proces regjistrimi dhe proces verifikimi”, do të kryhen verifikime në përfundim të procesit të regjistrimit, nëse përputhen titujt e pronësisë, si dhe nëse përputhen sipërfaqet me të dhënat në dokumentacionin e pronësisë (certifikatë, kartelë pasurie dhe hartë treguese), pra ju bëjmë me dije se në përfundim të procesit të regjistrimit mund të ketë ndryshime në emra dhe vlerë sipas të dhënave ligjore, që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë.

Pronarët do të kompensohen për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me të dhënat që do të rezultojnë në dokumentacionin e pronësisë i cili do të paraqitet pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve (subjekti kërkues në bazë të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”).

Vlera totale e këtij shpronësimi është 185 903 868 (njëqind e tetëdhjetë e pesë milionë e nëntëqind e tre mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tetë) lekë.

**LISTA E PRONAREVE TE OBJEKTEVE GJATE SEGMENTIT RRUGOR
RRESHEN KALIMASH**

NR.	PRONARI	VLERA LEKE	SHENIME
1	Aleksandër Përleka	3797615	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
2	Gjovalin Përleka	2209394	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
3	Nikoll Gjok Nikolli	2870713	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
4	Fran Nikoll Prendi	1160789	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
5	Frok Nikoll Prendi	1725400	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
6	Preng Nikoll Prendi	2305430	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
7	Ded Preng Prendi	2733544	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
8	Gjergji Ndue Prenga	2980891	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
9	Ndue Pjetër Prenga	2459703	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
10	Mark Marfana	2375022	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
11	Gjet Kol Kolaj	2025166	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
12	Konstandin Kol Kolaj	2913239	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
13	Dod Kol Kolaj	1676373	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
14	Hil Preng Prenga (Ndoj)	2330284	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
15	Ndrec Ndue Lleshi	2226206	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
16	Pjetër Ndue Prenga	588217	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
17	Martë Ndue Prenga	1386707	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
18	Viktor Ndue Prenga	1451977	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
19	Shkurt Preng Ndoj	2967767	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
20	Shkurt Preng Ndoj	643256	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
21	Gjovalin Zef Skana	2781307	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
22	Gjergji Kol Skana	3154695	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
23	Tonin Preng Marku	2074754	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
24	Aleksandër Mark Simoni	4718199	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi

25	Gjergji	Frok	Marku		1927805	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
26	Mark	Zef	Shyti		4300441	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
27	Gjergji	Zef	Shyti		2482836	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
28	Pjetër	Zef	Shyti		2863432	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
29	Andon	Fran Shyti (Zef)			1122021	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
30	Dedin	Preng	Koka		622472	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
31	Nikoll	Ndue	Gjoka		3508870	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
32	Mrica	Mark	Leshi		1306180	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
33	Simon	Pjetër	Leshi		3437973	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
34	Gjon	Ndue	Ndoj		6148943	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
35	Mark	Preng	Gjoka		2294801	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
36	Viktor	Fran	Pjetri		7813552	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
37	Tonin	Dod	Nikolli		9159732	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
	Nikoll	Dod	Nikolli			Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
	Gjetë	Dod	Nikolli			Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
38	Ndue	Mark	Laska		1414794	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
39	Ndue	Mark	Gjoka		1086137	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
40	Mirash	Ndue	Përshqefa		3689481	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
41	Gjetë	Kol	Marleka		1535857	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
	Ndrec	Gjok	Marleka			Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
42	Pjetër	Dod	Shyti		3339444	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
43	Zef	Nikoll	Nikolli		4022168	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
44	Preng	Dod	Prenga		3339444	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
45	Pjetër	Dod	Prenga		3269133	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
46	Kin	Zef	Prenga		1725400	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
47	Ndue	Preng	Gjoka		1608316	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
48	Mark	Ndue	Gjoka		1659266	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
49	Preng	Mark	Mena		1963433	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
50	Gjin	Zef	Tuci		1428918	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi

51	Dod	Nikoll	Përshqefi		3607806	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
52	Preng	Ndue	Deda		2135666	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
53	Gjon	Ndue	Deda		2865447	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
54	Ferdinand		Deda		3247467	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
55	Zef	Mark	Vokrri		700000	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
56	Frok	Ndue	Vokrri		3075002	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
57	Ndue	Llesh	Lleshi		2591388	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
58	Martin	Ndue	Gjeta		689720	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
59	Mark	Gjon	Ndreca		6950239	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
60	Bibe	Ndue	Gjaci		2734260	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
61	Ndue	Preng	Nikolli		3030569	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
62	Zef	Ndue	Biba		2487385	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
63	Kol	Ndue	Biba		1602621	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
64	Ndue	Gjon	Lleshi		2824045	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
		Gjon	Mark			Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
65	Fran	Ndue	Lleshi		1700000	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
66	Ndue	Zef	Lleshi		2483565	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
67	Ndue	Varf	Loka		1102258	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
68	Anton	Frok	Vokrri		1874042	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
69	Ndue	Zef	Pepa		2221526	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
70	Gjon	Zef	Pjetri		3032902	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
71	Gjin	Gegë	Pjetri		2320463	Proçes regjistrimi dhe Proçes verifikimi
	TOTALI				185903868	

KËRKESË

Nr.109/1, datë 15.11.2007

Shpallje kërkesë për shpronësim publik

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të pusit të ujit nr.3 Vrion dhe lidhjes me tubacionin e ujësjellësit të Navaricës.

Subjekti kërkues i këtij objekti është bashkia Sarandë. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga Komisioni i Posaçëm i Shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronari që ka emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruar me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE TË CILËT DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË PUSIT TË UJIT NR.3 VRION DHE LIDHJES ME TUBACIONIN E UJËSJELLËSIT TË NAVARICËS

Nr.	Emri	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi 1/m ²	Vlera në lekë
1.	Haramb Koci Papa	750 m ²	320	240 000
2.	Jani Koci Papa	850 m ²	320	272 000
	Shuma	1 600	320	512 000

Vlera totale e këtij shpronësimi është 512 000 lekë (pesëqind e dymbëdhjetë mijë) lekë.

KËRKESË

Shtetësja Feruze Bushi, e bija e Maliqit dhe Shahes, e datëlindjes 1962, lindur dhe banuese në Darezeze, Fier, kërkon shpalljen të vdekur të bashkëshortit të saj, Ferat Bushi.

KËRKUESJA
Feruze Bushi

KËRKESË

Shtetësja Dhurata Koxhaj, e bija e Azbiut dhe e Lirisë, e datëlindjes 1973, lindur dhe banuese në lagjen "Çlirimi", Berat, kërkon shpalljen të zhdukur të bashkëshortit të saj, Armand Koxhaj.

KËRKUESJA
Dhurata Koxhaj

KËRKESE

Shtetasi Taulant Avdurramani, i biri Nazmiut dhe i Floreshës, i datëlindjes 1967, lindur dhe banues në Fier, kërkon shpalljen të vdekur të babait të tij, Nazmi Avdurramani.

KËRKUESI
Taulant Avdurramani

**Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 258 472 (Kryeredaktori)
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2007 është 16 000 lekë.**

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. KUSHTETUTA E SHQIPËRISË
2. REGJISTRAT E NOTERISË
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHA TË NDRYSHME

BOTIME TË REJA (Të përditësuara gusht 2007)

KODI PENAL

KODI I PROCEDURËS PENALE

KODI PENAL dhe KODI I PROCEDURËS PENALE (i bashkuar)

KODI CIVIL

KODI I PROCEDURËS CIVILE

KODI I PUNËS

KODI I FAMILJES

PËRMBLEDHËSE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL

Së shpejti në treg:

- Përmbledhëse e legjislacionit për taksa dhe tatime
- Përmbledhëse e legjislacionit për pronat

Hyri në shtyp më 22.11.2007
Doli nga shtypi më 22.11.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja “Nënë Tereza”
Tiranë, 2007

Çmimi 20 lekë